

VENDIM
Nr.46, datë 21.1.2009

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.1, DATË 10.1.2007 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E RREGULLAVE PËR
PROKURIMIN PUBLIK”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 27 e 75 të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në “Rregullat për prokurimin publik”, që i bashkëlidhet vendimit nr.1, datë 10.1.2007, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat e mëposhtme:

1. Shkronja “d” e pikës 2 “Prokurimi i përqendruar dhe organi qendror blerës”, të kreut 1, “Organizimi i prokurimit publik”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“d) Organi qendror blerës shqyrton dhe miraton specifikimet teknike, të dërguara nga autoritet kontraktore.

Nëse organi qendror blerës gjykon se specifikimet teknike nuk janë përgatitur në përputhje me ligjin për prokurimin publik ose se mund të shkaktojnë dështim të procedurës së prokurimit, kryen rishikimin dhe modifikimin e tyre.

Për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën me specialistë të fushës, të institucioneve përgjegjëse, si dhe me specialistë të jashtëm, vendas ose të huaj, për unifikimin e specifikimeve teknike, në përputhje me standardet.

Nëse autoritetet kontraktore, në përcaktimin e të dhënave sasiore, kanë marrë për bazë çmime të ndryshme, për mallra dhe shërbime të të njëjtit lloj, organi qendror blerës bashkërendon punën për testimin e tregut dhe përllogarit të dhënat sasiore, sipas fondit të vënë në dispozicion.”.

2. Shkronja “a” e pikës 1 “Kufijtë monetarë” të kreut II “Rregulla të përgjithshme të prokurimit”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Në përputhje me nenin 27 të ligjit për prokurimin publik, kufijtë monetarë janë:

i) Kufiri i lartë monetar:

- 1 200 000 000 lekë, për kontratat e punëve publike;
- 200 000 000 lekë, për kontratat publike të shërbimeve dhe mallrave.

ii) Kufiri i ulët monetar:

- 12 000 000 lekë, për kontratat e punëve publike;
- 8 000 000 lekë, për kontratat publike të shërbimeve dhe të mallrave.”.

3. Në kreun III “Dokumentet e tenderit” bëhen ndryshimet e mëposhtme:

A. Në fjalinë e parë të paragrafit të dytë të shkronjës “ë” të pikës 2 “Informacion i përgjithshëm”, fjalët “... e cila llogaritet si diferencë e çmimit më të lartë,... ” zëvendësohen me “... e cila llogaritet si diferencë ndërmjet çmimit të kontratës dhe çmimit më të lartë,.. ”.

B. Në pikën 3 “Informacion i veçantë” bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

a) Në nënndarjen e dytë të nënndarjes “i” “Për kapacitetet financiare dhe ekonomike” të shkronjës “a” “Kontratat për punë”, fjalët “...dhe ose raportet e menaxhimit financiar, të certifikuara nga një subjekt i jashtëm, i licencuar, auditimi;”, shfuqizohen.

b) Në nënndarjen “ii” “Për kapacitetet teknike dhe profesionale”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

i) në nënndarjen e parë, fjalët “licencat profesionale” zëvendësohen me “licenca profesionale e shoqërisë”;

ii) nënndarja e dytë shfuqizohet;

iii) në nënndarjen e tretë, fjalët “...dhe për numrin e stafit drejtues...”, shfuqizohen.

c) Në nënndarjen e dytë të nënndarjes “i” “Për kapacitetet financiare dhe ekonomike” të shkronjës “b”, “Kontratat e mallrave”, fjalët “... dhe ose raportet e menaxhimit financiar, të certifikuara nga një subjekt i jashtëm, i licencuar auditimi;”, shfuqizohen.

ç) Në nënndarjen e dytë të nënndarjes “i” “Për kapacitetet financiare dhe ekonomike” të shkronjës “c” “Kontratat e shërbimeve”, fjalët “...dhe ose raportet e menaxhimit financiar, të certifikuara nga një subjekt i jashtëm, i licencuar auditimi;”, shfuqizohen.

4. Në fund të paragrafit të parë të shkronjës “a” të pikës 5 “Procedura me negociim, pa shpallje të njoftimit” të kreut IV “Llojet dhe përzgjedhja e procedurave”, pas fjalëve “...asnjë ofertë...” shtohen “...apo kërkesë e përshtatshme...”.

5. Në kreun V “Zhvillimi i procedurave”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Shkronja “d” e pikës 1 “Njësia e prokurimit dhe urdhri për prokurim”, shfuqizohet.

b) Në pikën 2 “Hartimi i dokumenteve të tenderit”, bëhen këto ndryshime:

i) Në fund të shkronjës “b” shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje: “Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, botimi i dokumenteve të tenderit do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.”.

ii) Në fjalinë e parë të shkronjës “ç” fjalët “... i emëruar në përputhje me shkronjën “d”, të pikës 1, të këtij kreu,...” zëvendësohen me “... i cili emërohet me urdhër të veçantë të titullarit të autoritetit kontraktor...”.

c) Në fund të shkronjës “d” të pikës 3 “Dorëzimi i ofertave”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, dorëzimi i ofertave të operatorëve do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.”.

ç) Pas nënndarjes “i” të pikës 4 “Hapja dhe vlerësimi i ofertave”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Në rastin e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike, procedura e hapjes dhe e vlerësimit të ofertave do të bëhet sipas udhëzimeve të APP-së.”.

6. Në nënndarjen “Lista e shkurtër e kandidatëve”, të shkronjës “ç”, të pikës 3, “Shërbimet e konsulencës”, të kreut VI, “Zhvillimi i procedurës së kërkesës për propozim, prokurimi me vlera të vogla, shërbimet e konsulencës, konkursi i projektimit”, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Fjalja “Lista e shkurtër përfshin të pakën 3 kandidatë” zëvendësohet me “Lista e shkurtër përfshin të paktën 2 kandidatë”.

b) Fjalja e fundit e kësaj nënndarjeje shfuqizohet.

7. Në fund të shkronjës “c” të pikës 2 “Bashkimi i operatorëve” të kreut VII “Kushtet e përgjithshme për zbatim”, shtohet një paragraf, me këtë përmbajtje:

“Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i parë, i përcaktuar në paragrafin e shtatë të shkronjës “a” “Kontratat për punë” të pikës 3 “Informacione të veçanta” të kreut III, “Dokumentet e tenderit”, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha